



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2497/12 prot.

Datë 03/10/2024

V E N D I M
Nr. 1391/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03/10/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1283/2024, datë 19.09.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-15872-08-09-2024, me objekt: “Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme” me fond limit 7.999.967,23 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 23.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, me nipt: J62426002Q.
Adresa: Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik LIBRARI DYRRAHU” SHPK , me NIPT: L91418502J
Adresa: ZK 8517, e llojit trull plus ndertese 4 kate, me siperfaqe trualli 1’000 m2 dhe siperfaqe ndertese 330 m2, Durres, Spitall.

Autoriteti Kontraktor: Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a
Adresa: L.17 Rr. Dalip Peza.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 02.09.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1168/2023, ku vendosi:

[...]

1. *Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga “InfoSoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “Proçedurë e Hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-15872-08-09-2024, me objekt: “Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme” me fond limit 7.999.967,23 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 23.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a.*
2. *Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së protokolluar me tonën me nr. 2497/3 prot., datë 16.09.2024.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga “InfoSoft Office” SHPK.*
5. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 3916/26 prot., datë 27.09.2024, protokolluar me tonën nr. 2497/9 prot., datë 30.09.2024, autoriteti kontraktor Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1283/2024, datë 19.09.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Proçedurë e Hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-15872-08-09-2024, me objekt: “Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme” me fond limit 7.999.967,23 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 23.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a.

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 3916/26 prot., datë 27.09.2024, protokolluar me tonën nr. 2497/9 prot., datë 30.09.2024, autoriteti kontraktor Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1283/2024, datë 19.09.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Proçedurë e Hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-15872-08-09-2024, me

objekt: “Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme” me fond limit 7.999.967,23 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 23.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës së prokurimit dhe ka kualifikuar operatorin ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, në përputhje me vendimin Nr. 1283/2024, datë 19.09.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a ka zbatuar vendimin Nr. 1283/2024, datë 19.09.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-15872-08-09-2024, me objekt: “Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme” me fond limit 7.999.967,23 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 23.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

